



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME MALIQ SH.A  
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

Nr. 10 prot.

Maliq, më 20.10.2023

V E N D I M

Nr. 7 datë 20.10.2023

PËR

MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË LIKUIDIMIT DHE ÇREGJISTRIMIN E SHOQËRISË

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Maliq Sh.A në likuidim, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J64103106D, mbajti mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Mbledhja u thirr nga likuiduesi i shoqërisë zoti Petrit Kupe, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

1. Përfundimi i procedurave të likuidimit dhe çregjistrimi i Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Maliq Sh.A.

**Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vëren:**

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizimeve Maliq Sh.A është shpallur në likuidim në datën 16.03.2023. Vendimi si dhe njoftimet e kreditorëve janë publikuar rregullisht në QKB. Shoqëria nuk ka pasur aktive dhe detyrime, pasi në tërësi aktiviteti ekonomik dhe aktivitetet se bashku me detyrimet janë transferuar në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizimeve Korçë Sh.A. në datë 31.10.2022.

Likuiduesi ka hartuar bilancin e gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit në datë 16.03.2023. Gjithashtu likuiduesi ka hartuar një bilanc gjendje dhe një raport në datën 31.07.2023, të cilat janë miratuar me vendimin e kësaj asambleje Nr. 6, datë 31.07.2023. Pas kësaj likuiduesi ka vepruar me shpërndarjen e aktiveve dhe ka hartuar një raport përfundimtar të likuidimit në datën 10.10.2023. Shpërblimet për likuiduesin janë paguar.



**Pasi shqyrtoi raportin përfundimtar të likuidimit dhe diskutoi mbi çështjen më sipër të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve unanimisht,**

**V E N D O S I:**

- (1) Miratimin e bilancit të gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit në datë 16.03.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 1 Janar 2023 deri 16 Mars 2023 si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
- (2) Miratimin e bilancit të gjendjes në çastin e mbylljes së likuidimit në datë 31.07.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 16 Mars 2023 deri 31 Korrik 2023, si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
- (3) Miratimin e raportit përfundimtar të likuidimit të datës 10.10.2023, hartuar nga likuiduesi i shoqërisë Z. Petrit Kupe.
- (4) Miratimin e shpërndarjes së aktiveve, të drejtat ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A. në favor të aksionarëve si vijon:

<b>Aksionari</b>	<b>Përqindja e pjesëmarrjes</b>	<b>Vlera në Lekë e të drejtave në SHRUK Korçë SHA</b>
Bashkia Devoll	2.16%	7,081,753
Bashkia Korçe	5.69%	18,655,174
Bashkia Maliq	92.15%	302,122,013
<b>TOTAL</b>	<b>100.00%</b>	<b>327,858,940</b>

- (5) Mbylljen e procesit të likuidimit, prishjen e shoqërisë dhe çregjistrimin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Maliq Sh.A nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- (6) Ngarkohet likuidatori me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TË UK MALIQ SH.A**



**SOTIRAQ FILO**

**EDUARD DURO**